



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jednica Org.Unit	SP-02	Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No.	767-2/23
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages	03	Datë Datum: Date	23.01.24
PRISHTINË / A			No. 1

DATË/A:	03.10.2023
REFERENC-Ë:	23/767/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Kamila" SH.P.K. Malësi e Re- Prizren Fabrikë e çokollatës në Malësi e Re- Prizren
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Kamila" SH.P.K. Malësi e Re- Prizren, për fabrikën e çokollatës në Malësi e Re- Prizren, me Nr. Prot. 23/767/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkëngjitur kësaj shkresë gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative për operatorin "Kamila" SH.P.K. Malësi e Re- Prizren, për fabrikën e çokollatës në Malësi e Re- Prizren.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/767/MMPHI
Datë: 03.10.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Pëlqimit Mjedisor me Nr. 11/1970/1-ZSP-225/11, të lëshuar me dt. 31.10.2011, si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore të datës 02.10.2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "Kamila" SH.P.K. Malësi e Re- Prizren, i ndërpritet procedura administrative për pajisje me Leje, për fabrikën e çokolletës në ngastrën kadastrale nr. 688-2, zona kadastrale Lutogllavë Prizren.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Kamila" SH.P.K. Malësi e Re- Prizren, për fabrikën e çokolletës në ngastrën kadastrale nr. 688-2, zona kadastrale Lutogllavë Prizren. Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Një njoftim nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, a është vazhduar kontrata për shfrytëzimin e tokës komunale me nr. 04-353-, e lëshuar me

dt. 15.04.2011, pasi qe sipas kësaj kontrate qe keni prezantuar, shfrytëzimi i tokës është për 10 vite me mundësi te vazhdimi edhe 10 vite te tjera;

- Lejen ndërtimore ne bazë të cilës është lëshuar Aktvendimi i Komunës me nr. 04-351-14108, te dt. 20.12.2012, pasi qe ne këtë aktvendim nuk është përshkruar ngastra kadastrale qe te na mundësoj te krahasojmë a është Leja Ndërtimore ne përputhje me Pëlqimin Mjedisor me nr. 11/1970/1- ZSP-225/11, te dt. 31.10.2011.

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit te cekur me lartë sipas kërkesës se komisionit. Mirëpo disa informata shtese i ka sjellur pasi qe ju është mbyllur procedura dhe qe nënkuptohet jashtë afatit ligjor te parapare.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur të datës: dt. 06.06.2023, konstatoi se operatori nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë ne afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prizren;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda /
Department of Environment Protection and Waters

REFERENC-Ë:	23/767/81/MMPHI-DMMU
DATË/A:	03.10.2023
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Shpend Agaj, kryesues i komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin "Kamila" SH.P.K. Malësi e Re- Prizren Fabrikë e Çokollatës në Malësi e Re- Prizren

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokoli: 23/767/81/MMPHI-DMMU, të operatorit "Kamila" SH.P.K. Malësi e Re- Prizren, për fabrikën e Çokollatës në Malësi e Re- Prizren.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zivotnu Sredinu i Voduj
Department of Environment Protection and Water

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENC-Ë:	23/767/81MMPHI-DMMU				
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI				
CC:	Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Komisioni për Leje Mjedisore				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje ne kërkesën e operatorin "Kamila" SH.P.K. Malësi e Re- Prizren Fabrikë e Çokollatës në Malësi e Re- Prizren				
Nr. i zyrës:	1517	Lokacioni:	Ish pallati i mediave	Data:	03.10.2023
Br. kancelarije:		Kucni:	Rilindja, Prishtinë.	Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input checked="" type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuari Sekretar,

Komisionit për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 3957/23, me nr. prot. 3957-2/2023, të dt. 25.07.2023, duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L- 025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neni 8 i Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori "Kamila" SH.P.K. Malësi e Re- Prizren, ka aplikuar për pajisje me Leje Mjedisore me Nr. Prot. 23/767/81/MMPHI-DMMU, për fabrikën e Çokollatës në Malësi e Re- Prizren në ngastrën kadastrale nr. 688-2, zona kadastrale Lutogllavë Prizren, sipas Pëlqimit Mjedisor me Nr._11/1970/1-ZSP-225/11, të lëshuar me dt. 31.10.2011.

Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr._11/1970/1-ZSP-225/11, të lëshuar me dt. 31.10.2011;
- Komuna Prizren- Kontratë për shfrytëzimin e tokës komunale dhe përcaktimi i qirasë për ndërtimin e objektit të fabrikës së Çokollatës me nr. Prot. 04-353, të lëshuar me dt. 15.04.2011, me afat të vlefshmërisë dhjetë (10) vite me mundësi vazhdimi;
- Komuna Prizren- Aktvendim nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë me nr. Prot. 04-351-14108, të lëshuar me dt. 20.01.2012, për përdorimin e objektit për prodhimin e çokollatës (*mirëpo mungojnë ngastrat kadastrale për definimin se ku është objekti*);
- Komuna Prizren- Konkluzion nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor me nr. Prot. 04-353-14108, të lëshuar me dt. 18.01.2012;
- ARPL- Leje ujore për shfrytëzim të ujit me nr. 7632/22-ZSP-2023, të lëshuar me dt. 20.01.2023;
- ARPL- Leje ujore për shkarkim të ujit me nr. 7632/22-ZSP-2023, të lëshuar me dt. 20.01.2023.

Komisioni pas pranimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumentacionit si në vijim:

- Një njoftim nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, a është vazhduar kontrata për shfrytëzimin e tokës komunale me nr. 04-353-, e lëshuar me dt. 15.04.2011, pasi që sipas kësaj kontrate, shfrytëzimi i tokës është për 10 vite me mundësi të vazhdimit edhe 10 vite të tjera;

- Lejen ndërtimore ne bazë të cilës është lëshuar Aktvendimi i Komunës me nr. 04-351-14108, te dt. 20.12.2012, pasi qe ne këtë aktvendim nuk është përshkruar ngastra kadastrale qe te na mundësoj te krahasojmë a është Leja Ndërtimore ne përputhje me Pëlqimin Mjedisor me nr. 11/1970/1- ZSP-225/11, te dt. 31.10.2011.

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit te cekur me lartë sipas kërkesës se komisionit. Mirëpo disa informata shtese i ka sjellur pasi qe ju është mbyllur procedura dhe qe nënkuptohet jashtë afatit ligjor te parapare.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit te operatorit në fjalë, në takimin e komisionit te mbajtur me dt. 06.06.2023, në përbërje prej pesë (5) anëtareve, unanimisht, konstatojnë se operatori nuk i ka sjell dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, dhe si përfundim, rekomandon që ti mbyllet procedura administrative.

Vërejtje: kjo lënde është kthyer për ri shqyrtim nga ZSP me dt. 19.07.2023 dhe është rishqyrtuar me datë: 02.10.2023 nga komisioni ne përbërje prej tre (3) anëtareve.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjeni edhe propozim vendimin për mbylljen e procedurës administrative.

Komisioni:



Shpend Agaj, kryesues

Adem Tusha, anëtar

Përparim Terziu, anëtar

Fatmir Bytyqi, anëtar

Ilir Kryeziu, anëtar


Gjendet ne udhëtim zyrtar jashtë shtetit.

Nuk është prezent ne takim.

